




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA
DREJTORIA E ARSIMIT - UPRAVA ZA OBRAZOVANJE



Pranuar - Prilijeno Ma/Dana: 11.08.2020

Nr i organit broj Organa	Numri-Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
05-	323/20		-

Republika e Kosovës
Republik of Kosova
Republika Kosovo

Komuna e Vitisë
Municipality of Vitina
Opstina Vitina

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-068, për Arsimin në komunitet e Republikës së Kosovës neni 5 pika d, neni 35 pika l.të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr.04/L-032, dhe të Udhëzimit administrativ të MASHT-it, nr.15/2019 të dt.19.07.2019,për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes drejtorëve dhe të zv.drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese,Drejtoria e Arsimit shpall:

KONKURS PUBLIK (Rishpallje)

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në institucionet edukativo-arsimore

- Drejtor shkolle, në SH.F.M.U. „Hysen Terpeza” në Terpezë,
- Drejtor shkolle, në SH.F.M.U. „Safet Rexhepi” në Zhiti,
- Drejtor shkolle në SH.M.L.M. „Kongresi i Manastirit” në Pozhoran

Kushtet që duhet ti plotësojnë kandidatët që konkurojnë në këtë konkurs:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës,
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit: Master për udhëheqje,administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimin prej 330 ECTS,së paku 5 vite të shkollimit Universitar).
- Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS 5 vite të shkollimit universitar).
- Katërvjetqar(kualifikimin prej 240 ECTS 4 Vite të shkollimit universitar)
- Bachelor katërvjeçar kualifikimin prej 240 ECTS 4 vite të shkollimit universitar).
- Të kenë licencë të rregulltë të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësëve,ose të jetë në procedur të licencimit.
- Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim të aprovuar nga MASHT sipas rekomandimit të KSHLM.
- Të kenë përvojë pune në procesin edukativo-arsimor,sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës:
- Të ketë 5 vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për arsimin e mesëm të lartë:
- Të kenë 4 vite përvojë pune në arsim në procesin edukativo-arsimor për kandidatët në nivele tjera:

Kandidatët duhet të posedojnë-dorëzojnë këto dokumente:

- Kopja e letërnjoftimit,
- Diplomën e fakultetit të kryer për nivelinë përkatës,
- Në arsimin farafillor,fillor të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë(gjimnazë) dhe Qendra Burimore,kandidati/ja duhet të jetë i profilit arsimor,në bazë të normativit profesional për arsim të përgjithshëm:
- Për institucionin edukativo-arsimor profesionale dhe Qendra e Kompetencës,kandidati/ja duhet t'i përket profilit përkatës për institucionin edukativo-arsimor ku konkuron,në bazë të normativit për arsimin profesional:
- Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore:
- Dëshminë se nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim,dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët:
- Dëshmi për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor:
- Konceptin e Planin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor për të cilin ka konkuruar.
- Koncepti duhet të bazohet në fushat e cilësisë në arsim dhe të ketë 5-10 faqe tekst (një faqe për një fushë) me hapësirë 1.5,fonti i shkronjave 12,arial).Koncepti dorëzohet si pjesë e portofolios,por është edhe pjesë përbërëse kryesore e intervistës:
- Letër reference me përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimin paraprak nga një institucion publik-kredibil (si Ministria e Arsimit,Shkencës dhe Teknologjisë,DKA,këshilli drejtues i institucionit edukativo-arsimor,punëdhënësi paraprak,institucionet e arsimit të lartë dhe individë me të cilët ka punuar ngushtë në programe të ndryshme për arsim);
- Letër motivuese për vendin e punës për të cilin aplikon:
- Portofolio profesionale (shikohet në C):

- Kandidati/ja për drejtor zv drejtor nuk mund të jetë në funksion udhëheqës politik gjatë tri viteve para aplikimit-dëshmohet me Deklaratën nën Betim;
- Biografinë/Curriculum Vitae (CV).
- Licencën e mësimëdhënësit,dëshmi se është në process të marrjes së licencës;
- Diplomë-certifikatë për menaxhim dhe udhëheqje në arsim;
- Dokumentet e dorzuara duhet të janë origjinale dhe të vlefshme.

-Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë shtetit të Republikës së Kosovës si dhe nëpër kolegje private brenda Republikës së Kosovës, e që konkurojnë për këtë pozitë duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me udhëzimin administrativ nr.8/2010 të datës 22.06.2010, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të rrefuzoj ç'do aplikacion të kandidatëve të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet e konkursit.

-Kandidatët e interesuar aplikacionet i marrin dhe i dorëzojnë në Drejtorin Komunale të arsimit në Viti.
Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.
Dokumentet e pa kompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Më: 11.08.2020.Viti



Drejtoria e Arsimit